

PYETJE PËRGGJIGJE PËR KARTAT CHIP

→ CFARË ËSHTË NJË KARTË CHIP DHE SI NDRYSHON NGA KARTAT ME SHIRIT MAGNETIK?

Një kartë CHIP ka një mikroçip që ruan në mënyrë të sigurtë të njënjtë të dhëna si kartat me shirit magnetik p.sh. numrin e kartës, emrin e kartëmbajtësit dhe datën e skadencës. Mënyra se si përdoren kartat me Chip ndryshon pak nga ajo e kartave me shirit magnetik pasi:

- ✓ Transaksionet me karta Chip autentikohen nga një numër personal identifikimi (PIN). Kjo do të thotë që sa herë që ju kryeni një transaksion duhet të fusni dhe kodin tuaj PIN në vend që thjesht të firmosni një faturë. Kjo shton një nivel më të lartë sigurie si dhe rrit shpejtësinë e transaksionit.
- ✓ Kartat Chip duhet të futen në terminalin e pagesës dhe të qëndrojnë aty deri sa transaksioni të kryhet.

→ CILAT JANË PËRFITIMET E TË PASURIT NJË KARTË ME CHIP?

Një kartë me CHIP ju ofron më shumë siguri se një kartë me shirit magnetik pasi CHIP-i e bën më të vështirë kopjimin e palejuar të të dhënave të kartës. Kartat me Chip ju ofrojnë gjithashtu më tepër komfort dhe shpejtësi në kryerjen e transaksioneve.

→ SI FUNKSIONON CHIP-I DHE PIN-I?

Një CHIP i vendosur në kartën tuaj të debitit qëndron në themel të teknologjisë CHIP dhe PIN. Teknologjia e CHIP-it përdor procesim të sofistikuar për të identifikuar kartën legjitime si dhe e bën falsifikimin e tyre më të vështirë dhe më të kushtueshëm. Kjo teknologji verifikon PIN-in që ju fusni në terminalin e pagesave me PIN-in që gjendet në CHIP. Kjo mënyrë verifikon identitetin tuaj në vend kontrollimit të firmës mbi faturë.

→ DO MË DUHET QË TA JAP PIN-IN TIM NË INTERNET OSE NË TELEFON?

Asnjëherë mos e bëni të ditur PIN-in tuaj qoftë në internet apo në telefon. Ju mund të paguani për mallra dhe shërbime nëpërmjet telefonit apo internetit në të njëjtën mënyrë si më parë, duke dhënë numrin e kartës suaj që ndodhet në pjesën e përparme të kartës si dhe kodin e sigurisë (ky është numri tre-shifror që ndodhet në pjesën e pasme të kartës, mbi shiritin ku ju firmosni).

→ CFARË DUHET TË BËJ NËSE GABOJ PIN-IN


Ju keni të drejtë të fusni PIN-in deri në tre herë. Nëse e fusni atë gabim 3 herë rrjesht, edhe pse në tre vende të ndryshme, PIN-i juaj do të bllokohet dhe ju nuk do të jeni në gjendje të përdorni kartën tuaj deri sa PIN-i të zhblokohet (për më shumë kontaktoni bankën në numrat e afishuara telefonit). Nëse ju nuk e mbani mend PIN-in tuaj, atëherë duhet të paraqiteni pranë degës më të afërt të bankës sonë për të aplikuar për një PIN të ri.

→ MUND TA PËRDOR CHIP-IN DHE PIN-IN JASHTË SHQIPËRISE?

Po. Në fakt është shumë e rëndësishme që të dini PIN-in tuaj nëse do të udhëtoni jashtë Shqipërisë. Teknologjia CHIP dhe PIN është futur tashmë në shumë vende dhe mund të ndodhë që ju të mos jeni në gjendje të paguani apo tërhiqni para pa ditur PIN-in tuaj.

→ PO NËSE KARTA IME CHIP DHE PIN PËRDORET NË NJË PIKË SHITJEJE QË NUK ËSHTË CHIP DHE PIN?

Në këtë rast ju përsëri do të jeni në gjendje të kryeni një transaksion duke firmosur një faturë. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që ju, menjëherë sapo të merrni kartën, të firmosni në pjesën e pasme të saj në hapësirën e lënë për këtë qëllim.



Për asistencë dhe informacion, ju lutem kontaktoni

Shërbimin Helpdesk në numrat: **+355 4 2276 222/3 ; +355 692080903**